



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Numri i Çështjes	31160-01326-86-2023	Data e Regjistrimit	22/05/2023
Numri i Vendimit	86-2023-1022	Data e Vendimit	10/10/2023

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit Tirane E PERBERE NGA:

KRYESUES: Eriol Roshi

ANËTAR Blerona Hasa
Altina Nasufi

SEKRETARE Pamela Memushaj

Objekti: Anullimi dhe Shfuqizimi i aktit administrativ vendimi Nr. 337/2023 i Komisionit të Prokurimit Publik datë 03.05.2023, nr. 570/7 prot, vetem persa i perket pikes 6 te ketij vendimi qe percakton: "Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga *****".

Baza Ligjore : Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative i RSH; Ligji nr. 162/2020 "Përprokurimin publik", i ndryshuar (LPP); Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike"; Ligji nr. 32/2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion", Vendimi i Këshilli të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (VKM). Vendimin nr.766 date 13.10.2021 i KPP per Rregullave per Organizimin dhe Funksionimin e *****t te ***** *****
Dokumentat Standarte te Procedures se Hapur Loti Iv, Ura e Zëmçës — Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë

Përmbledhja e vendimit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, të zhvilluar në seancë gjyqësore,

bazuar në kërkimet, pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse, si edhe në aktet provuese të paraqitura nga palët në mbështetje të tyre,

në praninë e përfaqësueses të palës paditëse shoqëria Albavia sh.p.k e cila, në konkluzionet përfundimtare, ka kërkuar pranimin e padisë,

në prani të palës së paditur ***** dhe Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, të cilët kanë kërkuar përfundimisht rrëzimin e padisë,

në prani të personit të tretë në gjykim ***** , i cili në konkluzionet përfundimtare kërkoi pranimin e padisë,

në mungesë të personit të tretë shoqëria tregtare ***** , e cilët, ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e gjykimit,

dhe si e vlerësoi çështjen në tërësi

Vëren:

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes:

-

Pala paditëse ka paraqitur para kësaj gjykate padinë me objektin e sipërcituar.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se, në datën 18.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) procedura e ***** “Procedurë e Hapur” me objekt: “Loti IV, Ura e Zëmçës - Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë”, me fond limit 220,320,000, lekë pa TVSh

Në datën 02.11.2022 autoriteti kontraktor (AK) ka zhvilluar procedurën e ***** objekt-shqyrtimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në datën 05.12.2022, AK ka komunikuar vleresimet per tenderin (Faza e Vleresimit te Tenderit) duke renditur opertaoret ekonomik sipas ofertes me te leverdisshme, perkatesisht: (1) *****; (2) Pe-Vla-Ku *****; (3) 2T ***** , (4) ***** dhe (5) Salillari ***** , dhe per rrjedhoje AK i ka kerkuar shoqerise ***** (i pari ne renditje) dokumentacionin fizik.

Në datën 09.12.2022 ALBAVIA ka dorezuar dokumentacionin me shkresën e saj nr. 14714/12 prot.

Në datën 16.12.2022 ALBAVIA, është njoftuar në platformen (SPE), për skualifikimin e saj me argumentet se oferta eshte e pavlefshme pasi nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, siç kërkohen në pikën 2.39 të DST, sepse:

1-Mjeti me numer shasie 6498 Volvo L120, i deklaruar si skreper nga operatori ekonomik ne Formularin e Vetedeklarimit, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nuk rezulton te jete Skreper por Fadrome e perdorur.

2- Per Kamioncinen me targe TR5481P, nuk ka paraqitur certificate pronësie.

3- Per Kamioncinen me targe TR5569P, nuk ka paraqitur certificate pronësie.

*4- Per Fabriken e Asfaltobetonit S/N 1872, nuk ka paraqitur asnjë dokument. Për sa më sipër, oferta e OE-së "***** " ***** , rezulton e pavlefshme.*

Në datën 25.01.2023 autoriteti kontraktor me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) në rubrikën kërkesa ka njoftuar operatorin ekonomik "***** " SHPK si më poshtë vijon:
Kërkesë për dorëzim të dokumentacionit fizik Në mbështetje të LPP dhe rregullave të prokurimit publik, duke qenë se ju jeni kualifikuar në vend të parë në vlerësimin e ofertave, jeni të lutur të dorëzoni pranë autoritetit tonë kontraktor, dokumentacionin fizik ashtu siç kërkohet në DST, brenda 5 (Pesë) ditëve nga marrja e kësaj kërkesë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në datën 23.02.2023 AK ka shkualifikuar ofertën e Personit te Trete,
***** , me arsyetimin se:

- 1) *Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", Shoqëria ka paraqitur 10 shoferet e kërkuar sipas DST, por pa dokumentacionin e plote sepse mungonte certifikata nga ISHT-I për secilin prej tyre.*
- 2) *Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", Për 6 manovratorët e kërkuar nuk është paraqitur certifikata nga ISHT-i*
- 3) *Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", OE ofertues ne ofertën e tij është mbështetur me dokumentacion në kapacitetet e operatorit "Alko Impex Construction" shpk 3 teknike ndërtimi dhe 3 manovratorë, nuk janë paraqitur në listë pagesat e kërkuara për periudhën korrik-shtator 2022*
- 4) *Nga shoqëria mbështetëse "***** shpk, nuk janë paraqitur listë pagesat e kërkuara për periudhën korrik-shtator 2022, për të verifikuar punonjësit e paraqitur nga kjo shoqëri (teknike ndërtimi + manovratorë", të cilët do të mbështesin OE ofertues "*****_***** Construction"*
- 5) *Nuk janë paraqitur Dëshmitë e penalitetit për personat e deklaruar ne Formularin e deklarimit si aksioner, administrator apo drejtues të shoqërisë (sipas shtojcës nr. 8)*
- 6) *Ne piken 2.3.9 "Makineri dhe Pajisje", Për makineritë e kërkuara nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas DST. Konkretisht.....*

Ne vijim në datën 10.03.2023 është publikuar ne SPE, Njoftim Anulimi i procedurës së prokurimit, si dhe në buletin nr. 24 të datës 13.03.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në datën 15.03.2023 pranë KPP dhe AK, është administruar ankesa me nr. 561 prot, datë 15.03.2023 e ALBAVIA shpk, me anë të së cilës është kundërshtuar vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

Në datën 15.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 561 prot, datë 15.03.2023 e operatorit ekonomik "***** " SHPK, me anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me shkualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

ankimi.

Në datën 16.03.2023 pranë KPP dhe pranë AK, është administruar ankesa me nr. 570 prot e operatorit ekonomik "*****_***** *****" "*****" shpk, me anë të së cilës kundërshtohet vendimin e i KVO në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga kjo procedurë prokurimi si dhe duke kërkuar lënien të shkualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët e tjerë pjesëmarrës.

Me shkresën nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të Komisionit Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik pranë autoritetit kontraktor në lidhje me arsyet e skualifikimit si dhe informacion lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues "*****" SHPK e cila më vendimin nr. 1144/3 prot, datë 24.03.2023 ka vendosur pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Me shkresën Nr. 570/4 prot., datë 29.03.2023 me objekt "Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "*****_***** *****" "*****", KPP iu drejtua autoritetit kontraktor, "*****", duke i kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e arsyeve të skualifikimit të dorëzuar nga operatori ekonomik "*****_***** *****" "*****" SHPK, sipas kërkesës së bërë nga ana e autoritetit kontraktor më datë 07.02.2023, në lidhje me vërtetueshmërinë e kriterëve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Me shkresën nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dsipozicion të Komisionit Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "*****_***** *****" "*****" lidhur me vërtetueshmërinë e e kriterëve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*****_***** *****" "*****" SHPK e cila ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues konkretisht vetëm për pikën IV të arsyes së skualifikimit si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

*“Lidhur me Pikën IV të skualifikimit: 4. Nuk janë paraqitur Deshmite e penalitetit per personat e deklaruar ne Formularin e deklarimit si aksioner, administratorit apo drejtues të shoqërisë (sipas shtojces nr. 8). OE ankimues *****_***** ***** ***** ” ***** , pretendon se ky skualifikim është i padrejtë pasi nga OE ankimues është paraqitur shtojca nr. 8, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, sipas përmbajtjes së kërkuar nga AK në DST. Në nenin 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. Në interpretim të paragrafit të mësipërm, KSHA e konsideron të përmbushur kriterin e kushteve të përgjithshme të kualifikimit vetëm me paraqitjen e shtojcës nr. 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, duke i qëndruar strikt parashikimit të nenit 26, pika 6 të VKM nr. 285, e cila thotë se: 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të 14 këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion ose atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

Për sa më sipër, KSHA e pranon këtë pretendim pasi në nënin e sipërcituar përjashtohet paraqitja e dokumentacionit për shkronjën C të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 255. (personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerët ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së [.....].

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave të kryera, ***** me vendimin Nr. 337/2023, ka vendosur:

*1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ***** ,*

për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF-46203-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

10-17-2022, me objekt: "Loti IV, Ura e Zëmçës Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë", me fond limit 220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë), lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, *****.

2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" SHPK, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

3. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023 për operatorin ekonomik "*****" SHPK, dhe vendimit të KSHA-së Nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023 për operatorin ekonomik "***** ***** ***** *****"
*****.

4. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF- Kryqëzimi Proptisht, 46203-10-17-2022, me objekt: "Loti IV, Ura e Zëmçës Bishnicë", me fond limit 220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë), lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, *****.

5. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "*****"

"Impex General Construction" SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.

6. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga *****.

7. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e ***** *****

për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "*****" *****.

9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare ekonomik "***** ***** ***** *****" *****.

10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në lidhje me këtë vendimmarrje, pala e paditur KPP ndër të tjera ka arsyetuar se:

“Në këtë mënyrë, Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autotitëti kontraktor ka përcaktuar një kriter joligjor dhe diskriminues duke kërkuar paraqitjen e disa certifikatave ose dëshmime të kualifikimit për punonjës që realisht nuk ushtrojnë veprimtari në ato fusha për të cilat kërkohet të lëshohen certifikatat apo dëshmitë e kualifikimit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi në mënyrë eksplicite se për punonjësit shofer dhe manovrator të paraqitet dëshmi kualifikimi nga ISHTI apo institucione ekuivalente, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion” dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar. Në nenin 1 të “Objekti” të legjislacionit të sipërcituar është e specifikuar mjaft qartë fusha e veprimtarisë së tyre pra certifikimi i sigurisë nga rreziku elektrik dhe pajisjeve nën presion.

Duke mos qenë dakord me vendimin e palës së paditur, **për anullimin e procedurës së prokurimit publik**, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë padinë objekt gjykimi.

-

Pretendimet e palës paditëse në gjykim:

-

Pala paditëse pretendon, se vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) Nr. 337/2023 datë 03.05.2023, është një akt administrativ pjesërisht i kundërligjshëm lidhur me pikën Nr.6 të dispozitivit të atij vendimi dhe duhet shfuqizuar nga gjykata për këtë pikë. Pala paditëse pretendon:

- Rezulton gjatë gjykimit se, kriteri i kualifikimit në lidhje me kërkesën për deponimin e dëshmime të kualifikimit nga ISHTI ose institucione ekuivalente për shoferët dhe manovratorët, i vendosur në DST nga Autoriteti Kontraktor, shkak mbi të cilën KPP ka vendosur anullimin, është në përputhje me i) *ligjin për Prokurimin Publik por edhe me ii)legjislacionin sektorial ne fuqi, konkretisht ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar,*
- Në nenin 9 “Formimi i Punemarresve” parashikon se “Përdorimi i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

pajisjeve elektrike” bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse edhe kur është e nevojshme transporti i tyre, për qëllime të sigurisë dhe shëndetit, dhe përdorimit të mjeteve mbrojtëse për parandalimin e aksidenteve në punë.

- Ligji sektorial i lartepërmendur, në nenin 5 dhe nënparagrafi 2 të tij, ka dhënë përkufizim të qartë të veprimit që lidhet me përdorimin e pajisjes elektrike, duke përfshirë pa asnjë dyshim dhe transportin e tij, konkretisht përcaktuar siç më poshtë vijon:

Neni 2/5. “Përdorimi i pajisjes elektrike” kuptohet çdo veprim i lidhur me përdorimin e pajisjes elektrike, si vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, përdorimi, transporti, riparimi, modifikimi, mirëmbajtja, duke përfshirë edhe pastrimin.

- Në vendimin saj KPP ka arsyetuar se shoferet dhe manovratori nuk ushtojnë asnjë veprimtari as përdorim pajisje nën presion dhe as nuk instalojnë impiante elektrike
- Detyra e transportit lidhet drejtpërdrejtë jo vetëm me punëmarrësin me detyrë Shofer por edhe me Manovratorin i cili gjithashtu realizon transportin e pajisjeve elektrike nga karrocëria e kamionit deri në destinacionin e parashikuar në Projekt. Projekti i zbatimit ka Rubrike me zëra të veçantë në preventiv për Punimet Elektrike. Për më tepër, gjatë punimeve për realizimin e Projektit të zbatimit, të punësuarit (përfshirë shoferet dhe manovratorët) përballen me rrjet elektrik nëntokësor apo ajror ekzistues i cili duhet çvendosur ose hequr, e natyrisht transportuar.
- Nga pala e paditur, *****, nuk u provua se vendimi për anulimin e procedurës të ishte i mbështetur në asnjë kriter ligjor apo teknik por është thjesht vlerësim subjektiv i anëtarëve të KPK
- Gjatë gjykimit rezultojë nuk kishte asnjë vlerësim ekspertit/specialisti të fushës, me njohuritë e nevojshme për të kuptuar e zbërthyer Projektin e Zbatimit dhe Specifikimet Teknike objekt procedure prokurimi. Sa më sipër u dëshmuar edhe nga qëndrimi i të paditurit KPP mbajtur në seancën gjyqësorë të datës 05.10.2022 i cili nuk solli asnjë provë të rëndësishme, që të provonte që Vendimi i KPP për anulimin e procedurës mbështetej në argumente teknik të inxhinierëve si rrjedhojë e shqyrtimit të Projektit të Zbatimit e Specifikimeve Teknike.
- Pohimi i të paditurit (KPP), në seancë gjyqësorë, se vendimi për anulimin e procedurës konkurruese është marrë nga anëtarët e Komisionit Prokurimit Publik në mungesë të një ekspertize profesionale të Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, por duke u mbështetur në faktin se Autoriteti Kontraktor nuk e kishte të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

argumentuar kriterin në “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve te Kualifikimit” të objektit të prokurimit, të publikuar bashke me dokumentet e tenderi, nuk përfshihet në shkaqet e ligjshme të parashikuara nga neni 98 i LPP për anulimin e një procedure prokurimit, pasi mungesa e argumentimit të kriterit nga AK jo vetëm që nga njëra anë nuk e bën vendosjen e kriterit të paligjshëm e të gabuar, por nga ana tjetër nuk mund të konsiderohet as mangësi e rëndësishme për anulimin e procedurës së prokurimit sepse rëndësia e mangësisë lidhet me pasojën që sjell, pasojë të cilen i padituri KPP nuk e mbështet ne prova dhe argumente ligjore. Vendosja e krieteve te kualifikimit, referuar nenit 77 te LPP, është në sekrecionin e Autoritetit Kontraktor, mbështetur në gjykimin profesional të strukturave të posaçme te tij (AK) për nevojat që ka përmbushja e Projektit të Zbatimit objekt i procedurës konkurruese.

- Nga pala e paditur, *****, nuk u provua se Vendimi për anulimin e procedures te ishte i mbështetur ne një kriter evaziv dhe haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion” dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, për shkak se në të gjithë dispozitat e ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 jo vetëm që nuk ka asnjë kufizim të së drejtës se cilitdo punëmarrës që të instruktohet me qellim për tu aftësuar në përdorimin e pajisjeve elektrike e certifikuar për këtë, por përkundrazi shihet si një detyrim ligjor për çdo punëmarrës (dhe detyre për punëdhënës) që të instruktohet e pajiset me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalent.
- KPP referon gabim ne ligjin 32/2016 pasi ne këtë ligj nuk parashikohet, dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse si tek ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001. Operatoreve ekonomik nuk u është kërkuar dëshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalent mbi bazën e ligjit 32/2016 por ne mbështetje te ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar.
- I pabaze dhe i paprovuar është edhe arsyetimi i te paditurit KPP se kriteri eshte i paqartë dhe konfuz ne mënyren e plotësimit të tij, mbi dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucione të autorizuar, duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit ...ka vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik në lidhje me vërtetueshmërinë e dëshmimeve të kualifikimit nga ISHTI dhe nuk qendron sepse:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

- Qe kriteri është i qarte e jo konfuz në mënyrën e plotësimit të tij, ashtu si dhe fakti se ku behet lëshimi zyrtar i tij nga institucione te autorizuarra (dhe siç pretendon me lart KPP) provohet me faktin e përmbushjen që Operatoret Ekonomik pjesëmarrës në procedurë i kanë dhënë këtij kriteri, përmes plotësimi/depozitimit të dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI jo vetëm për Manovratorët dhe Shoferët por edhe për Karpentierët, Hekurthyesit, Hidrauliket, Elektracistet dhe Tekniket e Ndërtimit, mbi të njëjtin kriter, në të njëjtën pike “2.3.7. te dokumenteve të tenderit.
- Personi i Trete i cili megjithëse ka qene i qarte për mënyrën e plotësimit dhe dorëzimit të dëshmisë së kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI, që provohet me faktin se e ka plotësuar këtë dokumentacion për profesionet e lartpërmendura (Karpentieret, Hekurthyesit, Hidrauliket, Elektracistet dhe Tekniket e ndertimi), nuk e ka dorëzuar këtë dëshmi për Manovratorët dhe Shoferët, megjithëse i kishte të gjitha mundësitë, ashtu si dhe operatorët e tjerë ekonomik konkurrues.
- Kriteri i vendosur nga AK nuk shkakton kushte të pabarazie, si për personin e tretë ashtu dhe për ofertuesit e tjerë. Mbi bazën e të njëjtave kriterë në tender mori pjese edhe Padiësi se bashku me operatorët e tjerë ekonomik të interesuar, përfshirë edhe Personin e Trete. Pra operatorët ekonomik të interesuar në tender janë vendosur dhe trajtuar mbi te njëjtin kriter duke shuar kësisoj çdo insinuate pabarazie. Referuar nenit 3.2 te LPP: “*Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar*”, dhe është evidente që rrethanat dëshmojnë që të gjithë operatorët kanë pasur mundësinë e plotësimit të këtij kriteri. Edhe nëse ky kriter do vlerësohej i paqarte, konfuz, evaziv, për mënyrën e plotësimit/dorëzimit të tij nga operatorët ekonomik të interesuar, ligji ka parashikuar mjetin ligjor në dispozicion të tyre për sqarimet dhe ndryshimet në dokumentet e tenderit (neni 75 i LPP)
- I pabaze dhe i paprovuar është edhe arsyetimi i te paditurit KPP se kriteri ka penguar pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit dhe nuk qëndron. ***** ka zbatuar drejt nenin 74.2 duke i dhënë mundësi çdo operatori ekonomik të interesuar të ushtroje të drejtat e tij, pa asnjë kufizim “*Autoritetet ose entet kontraktore, nëpërmjet mjeteve elektronike, ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi*”.
- Siç theksuar edhe me lart, çdo operatori ekonomik të interesuar, i garantohet me ligj e drejta për të marre dëshminë kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI, në varësi të kërkesës së të interesuarit.
- Kjo vendimmarrje bie ndesh me shume vendimmarrje të këtij organi dhe konkretisht përmendet si referncë Vendimin nr.238/2021 date



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

25.05.2021 që ka marrë në shqyrtim ankesën të një operatori tjetër dhe ka arsyetuar : *“III. 1.7. [... Omissis...] Lidhur me këtë fakt, KPP gjykon se dokumenti Dëshmi për kualifikimin e sigurimit teknik/Certifikatë mbi sigurimin teknik të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes për pjesën më të madhe të punonjësve, ka për qëllim sigurimin teknik të punonjësve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në përputhje me ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, por nuk zëvendëson në asnjë rast dëshminë profesionale të cilën autoriteti kontraktor e ka kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit për të gjithë punonjësit. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik Nika SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk arrin të provojë se disponon punonjës të pajisur me dëshmi profesionale, në përputhje me numrin e kërkuar në kriterin e veçante të kualifikimit.*

III. 1.11. [... Omissis...] KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.....

*...III. 1.12. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimes do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin *****”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”....*

- KPP jo vetëm që nuk gjendet në asnjë prej rrethanave të Anulimit të Procedurës por vendimi dëshmon mungesën e koherencës me qëllimin që ka LPP për të rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e ***** (neni 2.1 i LPP) si dhe në mbrojtjen e vete interesin publik për të realizuar sa më parë ndërtimin e rrugës objekt tenderi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

- Vendimi i KPP për Anulimin e procedurës shkel parimin e proporcionalitetit (neni 12 K.Pr.A) pasi cenon interesat e ligjshme të Paditësit i cili ndodhet në kushtet e përfituesit të drejtpërdrejtë të procedurës së prokurimit, në rrethanat e pranimi të plote të ankesës së tij nga KSHA e AK ashtu si dhe për faktin se është klasifikuar me ofertën ekonomike me të leverdishme. Në kushtet kur pala paditëse, që totalisht në mirëbesim, konkurroi dhe u kualifikua me kriteret e vendosura nga AK, ajo nuk mund të dëmtohet nga pala e paditur KPP.
- I padituri KPP nuk ka shqyrtuar ankimin administrativ në themel, jo vetëm ndaj të gjitha pretendimet të ngritura nga Personi i Tretë por edhe të Argumentave kundërshtuese të paraqitura nga Paditësi ndaj ankesës së Personit të Tretë.
- Në këto kushte prej kësaj gjykate duhet të shfuqizohet vendimi i KPP dhe të shqyrtoje çështjen në themel referuar edhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.
- Bazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve Civile të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 12.02.2008, përpara se paditësi t'i drejtohej juridiksionit gjyqësor, ky i fundit kishte detyrimin të paraqiste ankimin administrativ brenda afateve të caktuara me ligj dhe të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga ligji. Mosshqyrtimi në themel i të gjitha kërkimeve dhe shkaqeve të ankimit nga organi administrativ, jo për faj të paditësit, përbën shkelje të ligjit nga organi administrativ dhe nuk pengon paditësin t'i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi. Në vendimin e mësipërm unifikues, gjykata është e detyruar të shqyrtojë çështje çështjen në rast se jo për faj të paditësit çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ. Për më shumë i bëhet referim vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë,
- "... nëse gjykata konstaton se ankimi administrativ, ndryshe nga ç'pretendon organi administrativ, është ushtruar në afat dhe ka qënë i shoqëruar nga dokumentet and nevojshme sipas kërkesave të ligjit, nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ.
- Gjykata, siç theksuam më sipër, e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse administrative organization and that is not the case të metat e ankimit). Nëse gjykatës i rezulton se jo për faj të paditësit (ankuesit) çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ, atëherë në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që garantojnë një proces të rregullt ligjor, është e detyruar të shqyrtojë çështjen në themel, duke qënë ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e çështjes."
- Prej shoqërisë Alko-Impex General Construction shpk, përveç kriterit të mësipërm që është i mjaftueshëm për tu skualifikuar nga ana e saj nuk



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

janë paraqitur listepagesat e kërkuara për periudhën korrik-shtator 2022, për te verifikuar punonjësit e paraqitur nga kjo shoqëri dhe operatori ekonomik mbeshtetes (teknike ndërtimi + manovratore)

- Shoqëria Albavia sh.pk ka plotësuar te gjithë kriteret e vendosura ne Dokumentet Standarte te Tenderit.
- I vetmi pretendim qe ka ngritur shoqëria ankuese është se: Referuar autorizimit te distributorit të paraqitur, nuk provohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit për materialin Hekur, Tubo te Brinjezuaara, dhe Cimento, me te cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertoje këto pajisje/mallra në ketë procedure prokurimi. Ky pretendim nuk qëndron pasi është verifikuar edhe nga AK qe ***** ***** ka paraqitur edhe autorizim dhe Kontrate bashkëpunimi.

Prapësimet e palës së paditur *****.

-

Pala e paditur ***** gjatë gjykimit ka prapësuar duke kërkuar rrëzimin e padisë me këto pretendime:

- ***** pasi ka kryer një përshkrim të rrethanave të faktit si dhe një argument mbi shkaqet e ngritura në ankim nga shoqëria "***** " sh.p.k dhe shoqëria "***** ***** ***** ***** " ***** gjykon se, referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se "*Se për punonjësit shofer dhe manovratorë nuk janë paraqitur certifikatat nga ISHT-i, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me veprimtarinë dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetror Teknik dhe Industrial, rezulton se ky institucion inspekton dhe certifikon pëmbushjen e standarteve rigoroze dhe rregulloreve për 1- instalimet në sistemin hidrokarbur, 2- instalimin dhe funksionimin e pajisjeve nën presion në përdorim nga bizneset e qytetarët si dhe 3- instalimin e përdorimin e pajisjeve elektrike të sigurta.* . Duke iu kthyer kriterit 2.3.7 nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që të disponohet ndër të tjera edhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. Ndërkohë që punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor si shoferët dhe manovratorët nuk kryejnë asnjë proces pune për asnjë nga përcaktimet e sipërcituara pra as për përdorimin e pajisjeve nën presion apo impianteve elektrike të specifikuar në ligjin nr 32/2016 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion*" dhe në ligjin nr 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, në mënyrë që ata të pajisen me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

- Akoma më tej një rregullim më i detajuar gjendet në Urdhrin nr 5, datë 05.10.2017 “Për Miratimin e Rregullores për Procedurat e Miratimit dhe Mbikqyrjes së organeve Evropiane të Notifikuara dhe Organeve të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit” të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këtë kontekst është e paqartë dhe konfuze mënyra e plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucione të autorizuar, kur punonjësit për të cilët është kërkuar dorëzimi i dëshmime të kualifikimit nuk kanë asnjë përputhje me veprimtarinë që ata ushtrojnë pra as përdorin pajisje nën presion dhe as nuk instalojnë impiante elektrike, duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi.
- Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret kriteri i mësipërm ka vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik në lidhje me vërtetueshmërinë e dëshmime të kualifikimit nga ISHTI kur punonjësit shofer dhe manovrator nuk ushtrojnë asnjë veprimtari si në instalimin e enëve nën presion ashtu dhe të impjanteve elektrike, të cilat rregullohen nga dispozitat ligjore të sipërcituara.
- Në këtë mënyrë, Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autotiteti kontraktor ka përcaktuar një kriter joligjor dhe diskriminues duke kërkuar paraqitjen e disa certifikatave ose dëshmime të kualifikimit për punonjës që realisht nuk ushtrojnë veprimtari në ato fusha për të cilat kërkohet të lëshohen certifikatat apo dëshmitë e kualifikimit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi në mënyrë eksplicite se për punonjësit shofer dhe manovrator të paraqitet dëshmi kualifikimi nga ISHTI apo institucione ekuivalente, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion” dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar. Në nenin 1 të “Objekti” të legjislacionit të sipërcituar është e specifikuar mjaft qartë fusha e veprimtarisë së tyre pra certifikimi i sigurisë nga rreziku elektrik dhe pajisjeve nën presion.
- Gjithashtu, referuar edhe gërmës c, të pikës 2, të nenit 2, të VKM 285, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht: ...2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: ...c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e *****;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

- Si dhe referuar nenit 7/3, të VKM 285, “për miratimin e rregullave të ***** ”, i ndyshuar, i cili parashikon shprehimisht: *..3. Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor.*
- Autoriteti kontraktor, referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të ngarkuar nga vetë autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konkretisht në faqen 23 të tij, ka dështuar të provoj, se mbi çbazë ligjore ka parashikuar hartimin dhe vendosjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.7, të Dokumentave Standarde të Procedurës së prokurimit objekt gjykimi, lidhur me certifikimin e punonjësve shofer dhe manovrator nga ISHTI ose institucione ekuivalente.
- ***** gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur.
- Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, ***** gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacion sektorial. ***** thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.
- Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin *****”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, ***** ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur ***** vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të *****”*, ku parashikohet se: *“[...]***** në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”*, në përfundim, ***** gjykon, se kriteret e kualifikimit në lidhje me kërkesat për disponimin e dëshmime të kualifikimit nga ISHTI ose institucione ekuivalente për shoferët dhe manovratorët është një kriter evaziv dhe haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 *“Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion”* dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 *“Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”*, i ndryshuar, mbi të cilin KVO ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ndaj përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

- Nga sa mësipër, KPP gjykon, se vendimi nr. 337/2022, datë 03.05.2023, i Komisionit të Prokurimit Publik, mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt gjykimi, është i drejtë, dhe pretendimet e palës paditëse nuk qëndrojnë.

Personi i tretë *****, ka prapësuar në lidhje me padinë, duke parashtuar shkaqet mbi pranimin e padisë:

- E drejta që i ka dhënë ligjvënësi KPP për të përcaktuar rregullat e organizimit dhe funksionimit nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit dhe kushte të tij (neni 11 i K. Pr.Administrative).
- Mënyra se si ka disponuar KPP, tejkalon rolin e saj të dhënë me ligj. Të vepruarit në kundërshtim me kompetencat e dhëna me ligj, duke i tejkeluar ato përtej qëllimit që ka ligji, e bën veprimin të paligjshëm.
- Vendimi i KPP-së për anulimin është në kundërshtim me aktin nënligjor të ligjit sektorial, VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
- Referuar nenit 103 të VKM-së, rezulton se: "Përpara lidhjes së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

kontratës, KPP ka të drejtë të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin/entin kontraktor të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin".

- Pra, vendimi i anulimit të procedurës që ka vendosur komisioni mund të merret pasi është shpallur fituesi dhe do të lidhet kontrata, pra KPP mund të anulojë vetëm lidhjen e kontratës dhe këtë vetëm në atë fazë që përcakton ligji. Në këtë rast dhe vetëm në këtë rast KPP përpara lidhjes së kontratës, mund të anulojë procedurën kur gjykon se një vendim apo veprim i AK ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji.
- Fakt që në rastin konkret as ka ndodhur dhe as është pretenduar nga AK në kërkesën për anulim procedure. Si konkluzion në rastin në shqyrtim, nuk jemi në këtë fazë që KPP të mund të marrë një vendim anulimi.
- Dispozitivi i vendimit nr. Nr. 337/2023 është i paqartë, i pakuptueshëm, jo logjik, lidhur me pasojat e tij dhe zbatimin e tij, kur, me të të njëtin vendim, nga njëra anë urdhëron AK të anulojë procedurën e prokurimit dhe nga ana tjetër, me të njëjtin Vendim urdhëron AK që të vijojë me procedurën duke kryer: (i) rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHAsë Nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023 për oe "Albavia" SHPK, dhe vendimit të KSHA-së Nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023 për oe "Alko Impex General Construction" SHPK për pjesën e pranuar; (ii) të rishikojë arsyet e skualifikimit të oe "Alko Impex General Construction" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
- Vendimi i KPP është i paligjshëm pasi shkel parimin e proporcionalitetit (neni 12 K.Pr.A) Anulimi i procedurës cënon interesat e ligjshme të Paditësit i cili ndodhet në kushtet e përfituesit të drejtëpërdrejtë të procedurës së prokurimit, në rrethanat e pranimit të plotë të ankesës së tij nga Komisioni Shqyrtimit të Ankesave i AK (Vendimi i KSHA datë 24.03.2023), Vendimit Nr.337/2023 të KPP për mbylljen e çështjes dhe urdhërimit për rivlerësimin e procedurës për Albavia shpk në zbatim të vendimit të KSHA lartëpërmendur, ashtu si dhe për faktin se është klasifikuar me ofertën ekonomike më të leverdishshme.
- Parimi i proporcionalitetit kërkon një balancim midis synimit apo qëllimit që realizohet me anulimin e tenderit nga KPP, kundrejt cënimit të interesave legjitime të Paditësit.
- Sic rezulton nga përfundimet arsyetuese në Vendimin e KPP-së, anulimi i procedurës së prokurimit, bëhet me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.
- Me arsyetimin e dhënë nga KPP-ja , pretendohet se operatoreve ekonomik janë trajtuar në pabarazi dhe diskriminuar, për shkak të kriterit të kualifikimit në lidhje me kërkesat për disponimin e dëshmimeve të kualifikimit nga ISHTI ose institucione ekuivalente për shoferët dhe manovratorët mbi të cilin KVO ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

- Referuar Vendimit të KPP, pabarazia dhe diskriminimi vërehet se kriteri:
(A) është i paqartë dhe konfuz në mënyrën e plotësimit të tij nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucione të autorizuara, kur punonjësit për të cilët është kërkuar dorëzimi i dëshmimeve të kualifikimit nuk kanë asnjë përputhje me veprimtarinë që ata ushtrojnë pra as përdorin pajisje nën presion dhe as nuk instalojnë impiante elektrike, duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi.
- (B) ka penguar pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit
- (C) është një kriter evaziv dhe haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion" dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike".
- Po ti referohemi shtojcën nr. 7/2 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" në pikën 2.3.7 "Kapaciteti Teknik" në DST, rezulton, se tek ky kriter del e përcaktuar qartë në dokumenti që duhej plotësuar/dorëzuar në AK për Manovratorët dhe Shoferët, por edhe për Karpentierët, Hekurthyesit, Hidrauliket, Elektracistet dhe Teknikët e Ndërtimit është: deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente. Fakti që mënyra e plotësimit të këtij kriteri ishte i paqartë, dhe jo siç pretendon KPP, vërtetohet me faktin se Operatorët Ekonomik pjesëmarrës kanë plotësuar/depozituar dëshmitë të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalent për Karpentierët, Hekurthyesit, Hidrauliket, Elektracistet dhe Teknikët e Ndërtimit mbi të njëjtin kriter, në të njëjtën pikë "2.3.7. të DST-së.
- Gjithsesi, edhe nëse ky kriter do vlerësohej i paqartë, konfuz, evaziv, për mënyrën e plotësimit/dorëzimit të tij nga operatorët ekonomik të interesuar, ligji ka parashikuar mjetin ligjor në dispozicion të tyre për sqarimet dhe ndryshimet në dokumentet e tenderit (neni 75 i LPP) "Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit".
- Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar". Dëshmia nga ISHTI ose institucione ekuivalent, mund të merret nga kushdo i punësuar nga operatorët ekonomik, është e pakufizuar. Pra, është evidente që nuk ka ngushtim të konkurrencës sepse dëshmia e kërkuar ka akses të plotë për tu përfituar nga kushdo i interesuar. Përsërisin faktin se cilido oe i interesuar që mund të kishte kundërshtime mbi këtë kriter ka patur mjetin ligjor për të kërkuar sqarimin dhe ndryshimin e tij, në afatin procedural të LPP, por një gjë e tillë nuk është kërkuar.
- Gjithashtu nuk gjendemi përpara një kriteri evaziv për sa më lart sqaruar, duke qenë se është i qartë në përcaktimin e tij se çfarë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

kërkohet të përmbushet por duke referuar edhe ne organin lëshues të *"deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalent"*.

- KPP shton se nuk është në përputhje me legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion" dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike".
- Në vështrim të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 gjejmë se: Neni 1 "Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë garantimin e sigurisë së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga rreziku elektrik".

Neni 2/5 (Perkufizime). "Përdorimi i pajisjes elektrike" kuptohet çdo veprim i lidhur me përdorimin e pajisjes elektrike, si vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, përdorimi, transporti, riparimi, modifikimi, mirëmbajtja, duke përfshirë edhe pastrimin".

Neni 9/a (Formimi i Punemarresve) "Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse."

Rezulton se ligji i jep të drejtën cilitdo "punëmarrës" që të aftësohet në përdorimin e pajisjes elektrike, duke e dëshmuar me certifikatën përkatëse.

- Në të gjithë dipsozitat e ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 nuk ka asnjë kufizim të së drejtës për të përfituar nga ai, por përkundrazi shihet si një detyrim ligjor për zbatuesit e tij. Aq e vërtet është kjo sa Paditësi, e ka pambushur këtë kriter për të gjithë shoferët dhe manovratorët e kërkuar në tender dhe këtë e provojmë me dëshmitë përkatëse të paraqitura në tender. Mundësi të njëjtë ka pasur çdo operator sipas këtij ligji.
- Operatorëve ekonomik nuk u është kërkuar dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalent mbi bazën e ligjit 32/2016 por në mbështetje të ligjit nr.8734, datë 01.02.2001.
- Gjykimi i KPP-së, se AK duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi dëshmon mungesën e koherencës me qëllimin që ka LPP për të rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik (neni 2./1 i LPP) si dhe në mbrojtjen e vetë interesin publik për të realizuar sa më parë ndërtimin e rrugës objekt tenderi.
- Për të mundësuar ndërtimin e rrugës AK ka zhvilluar një procedurë duke siguruar mbështetjen financiare të planifikuar nga Buxheti i Shtetit e cila për shkak të anulimit nga KPP, jo vetëm që nuk realizohet menjëherë për të përmbushur nevojat e komunitetit por edhe bën të pasigurte mundësinë e alokimit e fondit të planifikuar për procedurat e ardhshme.
- Si konkluzion, për gjithë sa më sipër, rezulton se anulimi i procedurës së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

prokurimit, për qëllim trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues të gjithë operatorët ekonomikë, është i pambështetur në faktin, rrethanat objekt gjykimi dhe ligj.

- Pala paditese sipas vendimit të KPP-së është kualifikuar praktikisht dhe nuk mund t'i hiqet kjo e drejtë pasi procedura nuk lejohet me ligj të anulohet, edhe sikur të pranojmë se kriteri në DST për certifikimin nga ISHTI të shoferëve dhe manovratorëve ka qenë i paligjshëm. Sipas Kodit të Procedurave Administrative, shprehimisht pika 2 e nenit 114 të tij: Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë. Nëse pala përfituese është në mirëbesim, një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm.. nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.
- Pala përfituese nuk vlerësohet se është në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë, bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë të dhënë, me faj, nga vetë pala.
- Në kushtet kur pala paditëse është në mirëbesim, konkuroi dhe u kualifikua me kriteret e vendosura nga AK, ajo nuk mund të dëmtohet nga pala e paditur KPP.
- Pra, procedura konkurse nuk mund të anulohet edhe nëse kriteri i evidentuar nga KPP në DST si shkak anulimi do të konstatohej në kundërshtim me ligjin, në kushtet kur subjektet garuese (Paditësi) në procedurën prokurore ka arritur përfitime si pasoje e zbatimit të procedurës dhe të gjitha kërkesave në DST, në kushtet e mirëbesimit.
- Mirëbesimi është më shumë evident në kushtet kur të gjithë subjektet garuese përpara se të hynin në garë, pasi u njohën me kriteret e kërkuara, kishin të gjitha mundësitë të përpiqeshin për plotësimin e këtij kriteri siç ka bërë pala paditëse, e cila i përmbushi ato dhe rezultoi e kualifikuar, referuar Vendimit të AK dhe KPP.
- Gjate gjykimit u provua që ky kriter në asnjë moment nuk ka qenë një kriter i vendosur në abuzim të ligjit dhe aq me pak diskriminues.
- Po ashtu gjate gjykimit është konfirmuar se analiza që është bërë nga ana e KPP për kriterin e konstatuar si në shkëlqje të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, nuk ka pasur asnjë element tekniko-inxhinierik për të faktuar këtë vendimmarrje të KPP kjo e pohuar dhe nga Juristja gjate Gjykimit ku nuk paraqiti asnjë prove vërtetuese.
- Për të gjitha sa me sipër, duke qënë se nga ana e Bashkisë Pogradec ky kriter konsiderohet i vendosur në përputhje me përmasat natyrën dhe objektin e kontratës si dhe në asnjë moment gjate gjeth procesit të prokurimit publik nuk është favorizuar apo diskriminuar asnjë operator ekonomik, gjithashtu duke pasur parasysh interesin me të lartë i cili është interesi publik për lidhjen e kontratës dhe zbatimin e objektit, kërkohet pranimiti i padisë, sipas kërimit të saj.

Avokatura e Shtetit, në konkluzione përfundimtare ka kërkuar rrëzimin e kërkesës padisë si të pambështetur në ligj e në prova, duke parashtruar:

- Lidhur ankimin e palës paditëse, Avokatura e Shtetit ka pretenduar se, për sa kohë ankesa e tij mbi skualifikimin drejtuar AK është pranuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave dhe në kushtet kur shoqërisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

“***** ” sh.p.k i është kualifikuar oferta, rrjedhimisht kjo ka sjellë plotësimin e qëllimit të tij, nëpërmjet kualifikimit. Kjo është dhe arsyeja pse KPP ka mbyllur shqyrtimin e çështjes dhe autoriteti kontraktor duhet të rivlerëojë procedurën.

- Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
- Autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial. Kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.
- Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin *****”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, ***** ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur ***** vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të ***** ”, ku parashikohet se: “[...]***** në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, në përfundim, gjykohet, se kriteret e kualifikimit në lidhje me kërkesat për disponimin e dëshmimeve të kualifikimit nga ISHTI ose institucione ekuivalente për shoferët dhe manovratorët është një kriter evaziv dhe haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion” dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, mbi të cilin KVO ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ndaj përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.*
- Sa më lart ASH pretendon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

- Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "***** ***** ***** *****" ***** , dhe mbi pretendimet e ankimuesit për operatorët e tjerë pjesëmarrës ***** , referuar gjykimit të mësipërm në pikën III.4, gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara.

Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit

- Lidhur me kushtet formale të padisë.

I. Gjykata Administrative e Apelit, konstaton se kjo çështje hyn në kompetencën e saj funksionale, në kuptim të Nenit 10/b të Ligjit Nr.49/2012, që parashikon se:

"2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj".

Kjo mosmarrëveshje ka objekt vendimin Nr. 337/2023, datë 03.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, me reference ndër të tjera edhe Ligjin Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 121/1 i të cilit parashikon se:

"1. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi".

II. Gjykata Administrative e Apelit konstatoi gjithashtu se, kjo çështje përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo hyn në kompetencën lëndore të saj, bazuar në Nenin 7 të Ligjit Nr.49/2012, sipas përmbajtjes së të cilit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

“Gjykatat administrative jane kompetente per:

- a) *mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik...”*.

Vendimi objekt padie është akt administrativ individual, në kuptim të Nenit 2/1,2 të Ligjit Nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, sipas përmbajtjes së të cilit:

“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Akt administrativ” është çdo akt administrativ individual dhe çdo akt nënligjor normativ.*
- 2. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”.*

III. Sipas Nenit 15 të Ligjit Nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar:

“Të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

- a) *çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik”.*

Paditësi Shoqëria “***** ” sh.p.k është një ndër ofertuesit që kanë marrë pjesë në një procedurë prokurimi të cilën e kanë ankimuar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i të cilit, i cilësuar në mospërputhje me pritshmërinë e ankuesit, është kundërshtuar nga ky i fundit me padinë objekt gjykimi.

IV. Në lidhje me afatin e kundërshtimit të vendimit objekt padie, Gjykata Administrative e Apelit tërheq paraprakisht vëmendjen mbi faktin se, Neni 18 i Ligjit Nr.49/2012, parashikon se:

- “ 1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve*

...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

2. Afati i mësipërm është 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë. Në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur paditësi ka marrë dijeni për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur paditësi jep shpjegime të besueshme për këto rrethana në padinë e tij.

Gjykata Administrative e Apelit vëren gjithashtu se, në lidhje me afatet e ushtrimit të të drejtës së padisë në Nenin 72 të ligjit, parashikohet se:

“ Të gjitha afatet për paraqitjen e padisë ndaj aktit apo veprimit tjetër administrativ janë 45 ditë, me përjashtim të rasteve kur në ligjet e veçanta është parashikuar ndryshe”.

Neni 121/1 i Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon se:

“ 1. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”.

Në kushtet kur Ligji Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” nuk parashikon afate të posaçme, padia kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik duhet të paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve.

Gjykata Administrative e Apelit konstaton plotësimin e kushtit formal të afatit, përse kohë padia me objekt Vendimin Nr. 337/2023, datë 03.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton e dorëzuar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 22.05.2023 pra brenda afatit ligjor 45-ditor.

V.Mbi themelin e pretendimeve.

Gjykata Administrative e Apelit i referohet parimit procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në neni 37, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, parim sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit administrativ. Sa i përket kuadrit ligjor, gjykata gjen të zbatueshme këto përcaktime të ligjit nr. 62/2020 “Për prokurimin publik”:

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin *****”, parashikohet shprehimisht se: *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin *****”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

-

16. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

-

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në kështu rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

deklarimin, si më poshtë vijon:

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit t? posaç? m, n? rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e *****, dhe ka statusin aktiv;*

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose q? ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk ?sht? ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë faktin, për ndryshje dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose të kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.“

Neni 98 pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht:
“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur
***** vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.“



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Ndërsa në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin *****”, përcaktohet se *“Përpara lidhjes së kontratës, ***** ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin*

Gjykata Administrative e Apelit konstaton se, pala paditëse shoqëria ***** “sh.p.k” kërkon nëpërmjet këtij gjykimi ndryshimin pjesërisht të aktit administrativ, Vendimit nr. 337/2023, datë 03.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, përsa i përket pikës 6 të vendimit në të cilin përcaktohet *“Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysht konstatimet e mësipërme të bëra nga *****.”*, në kushtet kur nuk qëndron vlerësimi i kryer nga pala e paditur KPP.

Gjykata vëren se sipas nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin *****” dhe objektit të prokurimit të zhvilluar nga AK ***** , në lidhje me realizimin e ***** ***** me objekt: *“Loti IV, Ura e Zëmçës - Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë”*, kriteri i kërkuara në DST, përkatësisht në shtojcën nr.7 , *“Kërkesat e veçanta për kalifikim”* pika 2.3.7 *“kapaciteti teknik”*, mbi *domosdoshmërinë e paraqitjes së certifikatës nga ISHT-I për kategorinë e shoferëve dhe manovratorëve*, përfshihet në kompetencat e kësaj të fundit, që në kërkesat për kualifikimin e operatorëve ekonomikë të përfshijë kriteret të cilat i cilëson të përshtatshme, për të zbatuar kontratën dhe për të realizuar me cilësinë dhe karakteristikat e kërkuara shërbimet apo investimet që synohen nga autoriteti kontraktor.

Sipas DST, rezulton se AK ***** në lidhje me *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 2.3.7 *“Kapaciteti Teknik”* ka përcaktuar:

“....Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) manovrator si dhe 10 (dhjetë) shofër të mjeteve të renda.

Për manovratorët dëshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe të figurojnë në listë pagesa të paktën për periudhën korrik - shtator 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Për shoferet leje drejtimi e vlefshme dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojnë në listë pagesa të paktën për periudhën korrik - shtator 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, t? VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Në rastin objekt gjykimi rezulton se, personi i tretë ***** , ka skualifikuar ofertën e OE "***** ***** ***** *****" sh.p.k., nga procedura e ***** "Procedurë e Hapur" me objekt: "Loti IV, Ura e Zëmçës - Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë", me fond limit 220,320,000, lekë pa TVSh.

Skualifikimi i ofertës së këtij OE nga kjo procedurë prokurimi veç të tjerash është kryer dhe për mosplotësimin e kërkesave kualifikuese të parashikuara në piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", ku sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se "Shoqëria ka paraqitur 10 shoferet dhe 6 manovratorët e kërkuar sipas DST, por pa dokumentacionin e plotë sepse mungonte certifikata nga ISHT-I për secilin prej tyre."

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, bazuar në analizën e këtij kriteri kualifikues si dhe arsyetimet mbi parregullshmërinë e specifikimeve teknike të DST dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të hartuara nga ana personit të tretë ***** , pala e paditur KPP, me vendimin nr.337/2023 veç të tjerash ka vendosur dhe mbi anilimin e procedurës së prokurimit dhe rihapjen e procedurës duke pasur parasysh konstatimet e kryera nga KPP. Në lidhje me këtë disponim është arsyetuar se ... *Vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparence në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedure prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

proces.....KPP gjykon se Autoriteti Kontrakttor ka hartuar dokumentat e tenderit në kindërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për PP....kriteret e kualifikimit nga AK suhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues...”.

Gjykata në shqyrtim të akteve të dosjes Gjyqësore, konkretisht vendimit të KSHA si dhe vendimet mbi skualifikimin e operatorve ekonomik, evidenton se në shkaqet e ankimit personi i tretë “***** ***** ***** *****” sh.p.k., nuk ka pasur pretendime mbi vetë kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuar në DST-së, por ka pretenduar thjesht mospërmbushjen e tyre të evidentuar si e metë nga AK si dhe vlerësimin e gabuar të personit të tretë AK ***** , në lidhje me skualifikimin e saj.

Ndryshe nga sa ka pretenduar OE “***** ***** ***** *****” sh.p.k mbi skualifikimin e tij nga procedura e ***** , rezulton se pala e paditur KPP, ka disponuar kryesisht mbi anulimin e procedurës së prokurimit dhe të rihapë këtë procedurë prokurimi duke mbajtur parasysht konstatimet e palës së paditur KPP në këtë vendim.

Pala e paditur KPP në këto kushte, ka vlerësuar se AK ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik.

Prandaj, ndonëse nuk përbënte shkak të ankimit të parashtruar nga OE ankimues “***** ***** ***** *****” sh.p.k dhe ishte vënë në lëvizje me këtë ankim vetëm në fazën e shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikim/kualifikimin dhe renditjen e operatorëve ekonomikë konkurrues, pala e paditur KPP e ka zgjeruar hetimin administrativ, duke vënë në bisedim kryesisht përputhshmërinë me ligjin dhe aktet nënligjore të specifikimeve teknike të DST dhe të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të hartuara nga personi i tretë AK ***** .

Por, duke u vënë në lëvizje vetëm kryesisht, këtë mënyrë vlerësimi e disponimi që ia njeh ligji, pala e paditur KPP e ka realizuar në dhomë këshillimi, pa kërkuar paraprakisht mendimin dhe qëndrimin me shkrim të OE konkurrentë dhe të personit të tretë AK ***** , në lidhje me përputhshmërinë e kërkesave kualifikuese me dispozitat ligjore.

Madje, në kushtet kur as nuk ishte ngritur dhe as ishte kërkuar prej AK apo OE pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit, në atë fazë të kësaj procedure dhe të asaj ankimore, këtë mangësi thelbësore procedurale, të mosdëgjimit të palëve pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit, pala e paditur KPP nuk e ka riparuar së paku për të realizuar një seancë dëgjimore me thirrjen e OE pjesëmarrës në procedurat ankimore dhe të personit të tretë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

AK Pogradec, pikërisht për të dëgjuar argumentet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me përputhshmërinë me ligjin dhe aktet nënligjore të specifikimeve teknike të DST dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të hartuara nga personi i tretë AK *****.

Gjykata, për të kryer një hetim të thelluar mbi atë çka ka disponuar KPP, gjatë gjykimit ka pyetur përfaqësuesen e palës së paditur nëse nga ana e tyre, gjatë vendimmarrjes për anulimin e procedurës së prokurimit, është marrë mendimi i ndonjë eksperti në lidhje me kriterin e kualifikimit “*certifikata e lëshuar ISHT-I*”. Në lidhje me këtë, përfaqësuesja e palës së paditur KPP është shprehur se nuk është marrë ndonjë mendim nga ekspertit teknik të fushës, si dhe nuk arriti të provonte me akte shkresore, se vendimmarrja e tyre ka qënë rrjedhojë e një hetimi të plotë, çka e bën të cënueshme qëndrimin e mbajtur nga KPP.

Gjykata vlerëson se organi publik në lidhje me procedurën e prokurimit, bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ka përcaktuar kritere kualifikuese përfshirë këtu dhe kriterin “*Shoqëria ka paraqitur 10 shoferet dhe 6 manovraret e kerkuar sipas DST, por pa dokumentacionin e plote sepse mungonte certifikata nga ISHT-I për secilin prej tyre.*”.

Në kundërshtim me atë ç’ka përmbahet në arsyetimin e vendimit nr. 337/2023 të KPP dhe atë ç’ka prapësohet nga pala e paditur KPP në gjykim, nuk jemi para një kriteri diskriminues/ apo kriteri të shprehur joqartë, kjo pasi vetë neni 77 i ligjit “Për prokurimin publik” në pikën 4 të tij flet për aftësitë profesionale që duhet të posedojë operatori ekonomik si dhe për përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës administrativ sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, ky kriter kualifikimi është vendosur për t’i shërbyer autoritetit kontraktor, në kuadër të evidentimit të ofertuesit i cili vërteton se zotëron ndër të tjera kualifikimet e nevojshme teknike dhe profesionale, kapacitete që lidhen me përvojën e duhur, reputacionin si dhe besueshmërinë për realizimin e kontratës administrative në mënyrë sa më optimale. Duke marrë për bazë ligjin dhe rregullat e realizimit të prokurimeve publike është e drejtë e autoritetit kontraktor të përcaktojë kritere kualifikimi, me kushtin që ato të lindin nga fryma e ligjit dhe të jenë në përputhje me dispozitat ligjore.

Kriteret e vendosura nga pala paditëse/autoritet kontraktor dhe të propozuar për tu hequr në kundërshtim me ligjin nga ***** përmes vendimit nr. 337/2023, vlerësohet nga Gjykata se janë të nevojshëm, që lidhen domosdoshëmërisht me qëllimin, parimet dhe me objektin që kërkohet të realizohet. Në këto kushte KPP nuk ka pasur shkak të motivuar për të disponuar mbi anulimin e procedurës së prokurimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në lidhje me pretendimin e palës së paditur se një nga shkaqet që propozohet heqja e kriterit kualifikues është edhe fakti se “*Autoriteti kontraktor, referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të ngarkuar nga vetë autoriteti kontraktor në Ssistemin e Prokurimeve Elektronike, konkretisht në faqen 23 të tij, ka dështuar të provoj, se mbi çbazë ligjore ka parashikuar hartimin dhe vendosjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.7, të Dokumentave Standarde të Procedurës së prokurimit objekt gjykimi, lidhur me certifikimin e punonjësve shofer dhe manovrator nga ISHTI ose institucione ekuivalente.*”, gjykata e vlerëson të pabazuar dhe si rrjedhojë duhet të rrëzohet.

Për vetë natyrën e procedurës së prokurimit publik si dhe rregullimeve të posaçme të ligjit/LPP, vlen të theksojmë se, përpilimi i DST si dhe proces verbalit si pjesë e saj janë detyra që ligji ja ka ngarkuar Njesisë së Prokurimit, e cila funksionon si një strukturë e posaçme pranë AK. Pasaktësitë e mundçme në hartimin e dokumentave, nuk mund të penalizojnë në këtë rast paditësin, i cili rezulton fitues në procedurën e prokurimit dhe nuk ka asnjë përgjegjësi mbi mënyrën e kryerjes së punës nga kjo strukturë. Në kushtet kur paditësi ka plotësuar kriteret e vendosura nga AK, mbi kualifikimin e tij si ofertë e suksesshme atëherë, kjo tregon se kriteret e vendosura qëndrojnë, janë të provueshme me certifikimet përkatëse të lëshuara nga ISHT-i për të gjithë kategorinë e punonjësve që kërkohet përfshirë këtu dhe punonjësit me detyrë “shoferë” dhe “manovrator”.

Gjithashtu gjykata vlerëson se dhe shoqëria “***** ***** ***** Construcion” sh.p.k ka pasur të gjitha mundësitë për tu pajisur me certifikatë nga ISHT-i dhe për punonjësit e kategorisë “shoferë” dhe “manovrator”, për sa kohë ajo ka paraqitur saktësisht këtë dokument, për pjesën tjetër të personelit, sipas përcaktimeve të kriterëve ne DST.

Në lidhje me e tarifën e parapagimit nga “***** ***** ***** Construcion”, Gjykata vlerëson në kushtet kur vendimi i KPP 337/2023 është gjetur i cënuaeshëm në pikën 6 të tij, si më lartë arsyetuar, Gjykata vlerëson se, në zbatim të nenit 120 “*Pagesa për ankimin*” të ligjit 162/2020, detyrohet pala e paditur KPP të marrë masa për kthimin e tarifës të paguar për efekt të ankimit administrativ nga person i tretë “***** ***** ***** Construcion”

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, për shkak të disponimit për pranimin e padisë, në zbatim të kriterëve të nenit 106, paragrafi i parë, të K.Pr.Civile, Gjykata Administrative e Apelit vjen në përfundimin se ato duhet t’i ngarkohen palës së paditur KPP.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

P Ë R ?? K Ë T O ?? A R S Y E ?

?

Gjykata pasi pa nenet 40, pika 1, shkronja "a" të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar??

Vendosi:

Vendos:

1. Pranimin e padisë së paditësit "***** "*****".
2. Shfuqizimin e pikës 6 të vendimit nr.337/2023 të Komisionit të ***** .
3. Detyrimin e të paditurit KPP të marrë masa për kthimin në buxhetin e shtetit të tarifës të paguar për efekt të ankimit administrativ nga person i tretë "***** ***** ***** Construcion" ***** .
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Ky vendim përbën titull ekzekutiv duke u ngarkuar zyra përkatëse e përmbartimit për ekzekutimin e tij.
6. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot në Tiranë më datë 10.10.2023

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.